



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2019:093368  
Datë: 30.05.2024  
Numri i dokumentit: 05760033

Ac.nr.545/20

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Hunaida Pasuli - kryetare e kolegjit, Lumni Sallauka dhe Ardian Ajvazi, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike - kontestimore të paditëseve: A.M. e lindur K. dhe të miturës A.Z .M. me përfaqësuese ligjore, nënën A.M., nga fshati ....., Komuna e Pejës, e të cilat sipas autorizimit i përfaqëson B.A., avokat në Pejë, kundër të paditurit A.J. nga Peja, rr. “...” pn., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson S.B., avokat në Pejë, për shkak të kompensimit të dëmit material dhe jomaterial, duke vendosur sipas ankesës së të paditurit, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë - Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.49/17, datë 15.11.2019, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 24.05.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

I. REFUZOHET e pabazuar ankesa e të paditurit A.J. nga Peja, rr. “...” pn, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë - Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.49/17 i datës 15.11.2019, në pikën I, III dhe IV, të dispozitivit VËRTETOHET.

II. Mbetet e pashqyrtuar pika II e dispozitivit të aktgjykimit, në pjesën refuzuese të kërkesëpadisë.

**A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar C.nr.49/17, të datës 15.11.2019, ka vendosur si në vijim:

Pjesërisht aprovohet kërkesëpadia e paditëseve: A.M., e lindur K. dhe të miturës A(Z)M., që të dyja nga fshati .... Komuna e Pejës, ashtu që: I. DETYROHET i padituri A.J. nga Peja, që paditëseve në emër të dëmit jo material dhe material, si pasojë e kafshimit të qenit të tij, me dt.26.04.2016, t'iu paguaj shumat e specifikuar për secilën veç e veç, si më poshtë dhe atë:

Për paditësen A.M., e lindur K. në emër të dëmit jomaterial,

- për zhdëmtimin në emër të dhimbjeve fizike shumën prej 1.000 €
- për zhdëmtimin në emër të frikës 800 €,

Për paditësen - të miturën A. (Z) M.,

- për zhdëmtimin në emër të dhimbjeve fizike shumën prej 1.000€
- për zhdëmtimin në emër të frikës 800€ dhe
- në emër të dëmit material:
- për ushqimit të përforcuar shumën prej 200€
- për përkujdesje nga personi tjetër shumë prej 200€.

II. REFUZOHET kërkesëpadia e paditësve A.M., e lindur K dhe të miturës Arnisa (Zenun) Mulliqi, përtej shumës së gjykuar, për kompensimin e dëmit jo material, për paditësen A. M., e lindur K.: për kompensimin në emër të lëndimeve trupore shuma prej 2.000 €, për dhimbje të përjetuara fizike shumën prej 500€, për përjetim të frikës shumën prej 700€ dhe për shpenzimet e mjekimit 500 €. Për paditësen - të miturën A.Z.M.: për kompensimin në emër të lëndimeve trupore shuma prej 2.000€, për dhimbje të përjetuara fizike shumën prej 500 €, për përjetim të frikës shumën prej 700€, për ushqimi të përforcuar shuma prej 300 €, për përkujdesje nga personi tjetër shuma prej 300 € dhe për shpenzimet e mjekimit 500€, si e pabazuar.

III. DETYROHET i padituri A.J., nga Peja, që shumat e gjykuara si në pjesën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi t'i paguaj me kamatë ligjore të cilën e paguajnë bankat vendore si për deponimet në kursim në afat mbi një vit e pa destinim të përcaktuar duke filluar nga dt.15.11.2019, si ditë e vendimmarrjes e deri në pagesën definitive, në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi.

IV, DETYROHET i padituri A.J., nga Peja, që paditëseve t'i paguaj edhe shpenzimet procedurale në shumë prej 1.237,40 €.E të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, nga plotfuqishmëria e aktgjykimit e nën kërcënim të përmbarimit të detyruar.

Kundër këtij aktgjykimi i autorizuari i të paditurit në afat ligjor ka paraqitur ankesë, duke e atakuar aktgjykimin e goditur për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike, zbatimit të gabuar të së drejtës materiale dhe vendimit mbi shpenzimet e procedurës, me propozim që Gjykata Apelit aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë ta prish dhe lëndën t'ia kthej në rigjykim dhe vendosje apo ta ndryshojë duke e zvogëluar kërkesëpadinë e paditëseve edhe për pjesët e goditura me këtë ankesë si dhe për shpenzimet procedurale në kuptim të kundërshtimeve të cekura në këtë ankesë dhe të dispozitave të së drejtës materiale.

Përgjigje në ankesë nuk ka pasur.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e të paditurit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditëset, përmes të autorizuarit të tyre, me datë 26.01.2017, në gjykatën e shkallës së parë kanë paraqitur padi, të precizuar si në parashtresën e datës 29.10.2019, me arsye dhe kërkesë si në padi.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditëseve, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse si dhe vlerësimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.49/17, të datës 15.11.2019, me të cilin e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditëseve, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë, ka theksuar se me administrimin e provave ka vërtetuar gjendjen faktike se me datën....., rreth orës....., në rrugën “e .....” në fshatin....., Komuna e Pejës, paditësja A.M., bashkë me vajzën e saj paditësen-të miturën A, (e moshës 3 vjeçare), ishin duke shkuar për t’ia dërguar ushqimin burrit,përkatësisht babait të paditëses së dytë (Z.M.) dhe në rrugë janë sulmuar nga qeni, pa mbikëqyrjen e pronarit, këtu të paditurit, me ç ‘rast kanë pësuar lëndime trupore. Paditëses A. nga kafshimi i qenit i janë shkaktuar lëndime në gjoks (grithje dhe hematome nën lëkurore), dhe paditëses - të miturës Arnisa, nga kafshimi i qenit i janë shkaktuar lëndime në shpinë(regjionin e ijëve në anën e djathtë), për çka kanë kërkuar ndihmën mjekësore në Spitalin Regjional në Pejë. Gjykata ka konstatuar se këtu i padituri A.J., nga Gjykata Themelore në Pejë, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni i Kundërvajtjes, me Aktvendimin K.nr.1-5668/16, të dt.25.11.2016 është shpallur përgjegjës për dëmin e shkaktuar këtu paditëseve, ndërsa aktvendim është bërë i plotfuqishëm me datën 10.01.2017. Nga këto gjykata ka vlerësuar se baza juridike e kërkesëpadisë që i padituri të jetë përgjegjës për t’i kompensuar paditëset, gjen mbështetje në dispozitat e nenit 154, nenin 155, nenit 163, par.1 dhe 2, të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD).

Për lartësinë e kërkesëpadisë sa i përket dëmit material dhe jomaterial, gjykata e shkallës së parë, në cilësinë të provës ka marr për bazë mendimin e ekspertëve mjekësor Dr. Nazmi Morina ortoped - traumatolog dhe Dr. Mithat Bala neuropsikiatër, të cilët në mendimin e tyre profesional të dhënë në shqyrtimin gjyqësor të datës 23.07.2019, kanë konstatuar se: Paditësja Arlinda Mulliqi, si pasojë e këtij incidenti ka pësuar këto lëndime trupore: plagë kafshuese në regjionin e gjirit të majtë, grithje dhe hematome nën lëkuror, të cilat lëndime kualifikohen si lëndime të lehta trupore. Si pasojë e këtyre lëndimeve të pësuar, paditësja ka përjetuar dhimbje fizike të intensitetit posaçërisht të rëndë në kohëzgjatje prej gjysmë minute, dhimbje fizike të intensitetit të rëndë në kohëzgjatje prej 2 javë, dhimbje fizike të intensitetit të mesëm ka përjetuar në kohëzgjatje prej 2 javë, dhimbje fizike të intensitetit të mesëm 2 javë, dhimbje fizike të intensitetit të ulët 2 javë. Shëmtim trupor nuk ka pasur. Ndihma e personit të huaj nuk ka qenë e nevojshme. Ushqimi i përforcuar nuk ka qenë i nevojshëm. Terapia fizikale nuk ka qenë e nevojshme. Si pasojë e këtyre lëndimeve, paditësja ka përjetuar frikë dhe atë: frikë primare e cila ka zgjatur 5-10 minuta, sekondare të intensitetit të lartë në kohëzgjatje prej 6 orë.

Paditësja A.M., si pasojë e këtij incidenti ka pësuar këto lëndime trupore: sulm dhe kafshim nga qeni dhe plagë kafshuese në regjionin e ijëve në anën e djathtë, të cilat lëndime kualifikohen si lëndime të lehta trupore. Si pasojë e këtyre lëndimeve të pësuar, paditësja ka përjetuar dhimbje fizike të intensitetit posaçërisht të rëndë në kohëzgjatje prej gjysmë minute, dhimbje fizike të intensitetit të rëndë në kohëzgjatje prej 2 orë, dhimbje fizike të intensitetit të mesëm ka përjetuar në kohëzgjatje prej 2 javë dhe dhimbje fizike të intensitetit të ulët 2 javë. Shëmtim trupor nuk ka pasur. Ndihma e personit të huaj ka qenë e nevojshme në kohëzgjatje prej 2 javë. Ushqimi i përforcuar ka qenë i nevojshëm në kohëzgjatje prej 2 javë. Terapia fizikale nuk ka qenë e nevojshme. Si pasojë e këtyre lëndimeve, paditësja ka përjetuar frikë dhe atë: frikë primare e cila ka zgjatur 5 minuta, sekondare të intensitetit të lartë në kohëzgjatje prej 6 orë, frikë sekondare me intensitet të mesëm në kohëzgjatje prej 15 ditë dhe frikë sekondare me intensitet të ulët në kohëzgjatje prej 6 muaj.

Për mënyrën e vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë i është referuar neneve 154, 155, 163 paragraf 1 dhe 2, 183 paragraf 1 dhe 2 të LMD-së, lidhur

me nenin 7 paragraf 1, 319 dhe 323 të LPK-së. Për kamatën gjykata i është referuar nenit 382 të LMD-së. Vendimin lidhur me shpenzimet e procedurës e ka mbështetur në nenin 449, 452 dhe 463 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së përfundimi dhe qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare, në kuptim të nenit 194 të LPK-së, po ashtu aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të autorizuarit të paditurit se aktgjykimi i atakuar është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika n) e LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore për gjendjen faktike të konstatuar në mënyrë të gabuar apo jo të plotë nga ana e gjykatës së shkallës së parë, sepse në bazë të provave të administruara, gjykata e shkallës së parë i ka vërtetuar faktet që ndërlidhen me kohën vendin e shkaktimit të dëmit si pasojë e kafshimit të qenit, pronë e të paditurit, e që i padituri për shkak të mos mbikëqyrjes së kafshës është shpallur përgjegjës në procedurën gjyqësore për shkak të kundërvajtjes nga neni 12.1 të Ligjit për rendin dhe qetësinë publike. Sa i përket lartësisë së kërkesëpadisë, gjykata e çështjes këtë e ka provuar mbi bazën e ekspertizave mjekësore në të cilat konstatohet natyra e lëndimeve të paditëseve, përkatësisht dëmi jomaterial për shkak të dhimbjeve trupore dhe frikës së përjetuar, përfshirë edhe dëmin material për paditësen e mitur dhe atë në emër të shpenzimeve mjekësore, nevojën dhe kohëzgjatjen për kujdes nga personi tjetër si dhe nevojën për ushqim të përforcuar.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm. Në këtë rast i padituri edhe pse e ka kundërshtuar bazën juridike dhe lartësinë e saj gjatë shqyrtimit gjyqësor në shkallë të parë i njëjti me asnjë provë bindëse nuk ka argumentuar të kundërtën e pretendimeve nga padia edhe pse ka pasur për detyrë ta bëjë një gjë të tillë, në kuptim të nenit 7 paragraf 1 dhe 319 paragraf 1 të LPK-së.

Baza juridike e kërkesëpadisë, që i padituri të jetë përgjegjës për të kompensuar dëmin paditëseve, gjen mbështetje në nenin 163.1 të LMD, ku përcaktohet se “zotëruesi i kafshës së rrezikshme është përgjegjës për dëmin e shkaktuar prej saj”. Megjithatë në paragrafin 2 të këtij neni përjashtohet përgjegjësia e zotëruesit të kafshës, nëse provohet se ka treguar kujdesin dhe mbikëqyrjen e nevojshme, në rastin konkret, nga provat e nxjerra ka rezultuar se përgjegjës për kompensimin e dëmit është i padituri, pasi i njëjti është shpallur përgjegjës në procedurë gjyqësore të kundërvajtjes dhe nuk ka provuar ndonjë gjendje tjetër faktike nga e cila do të lirohej nga kjo përgjegjësi. Prandaj, gjykata e shkallës së parë mbi bazën e provave të rastit drejtë ka aplikuar ligjin material duke e detyruar të paditurin që paditëseve t’ia shpërblej dëmin e gjykuar si në dispozitivin e aktgjykimit të atakuar.

Gjithashtu, sa i përket lartësisë së dëmit në aktgjykimin e atakuar, rezulton se gjykata e shkallës së parë i ka marrë në konsideratë të gjitha rrethanat relevante për vendimmarrje, siç është në këtë rast natyra dhe pasojat e lëndimeve që kanë pësuar paditëset, llojin, kohëzgjatjen dhe intensitetin e dhimbjeve fizike, frikën dhe mënyrën se si është manifestuar frika, (vlerësimi këto të bazuara

si në ekspertizat mjekësore të administruara si provë), dhe rrethanat tjera si moshën e paditëseve dhe praktikën e mirë gjyqësore, e të cilat rrethana janë në pajtim të plotë me nenin 183 të LMD-së, duke siguruar që kompensimi të jetë në ekuivalencë më të mirën e cenuar dhe të shërbej si satisfakcion për paditëset.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, gjykata e shkallës së parë më rastin e vendosjes sipas aktgjykimit të atakuar, drejtë ka aplikuar të drejtën materiale kur ka gjetur se kërkesëpadia e paditëses A.M. është e bazuar lidhur me pjesën e kërkesëpadisë rreth kompensimit të dëmit material për ushqimin e përforcuar dhe ndihmën e personit të tretë, për arsye se me nenin 179 paragrafi 1 të LMD-së, përcaktohet se: “ Kush i shkakton tjetrit lëndim trupor ose ia dëmton shëndetin ka për detyrë të shpërblejë shpenzimet rreth mjekimit dhe shpenzimet e tjera te nevojshme lidhur më këtë, si dhe fitimin e humbur për shkak të pa aftësisë për punë gjatë kohës së mjekimit ”. Në këtë rast paditëses i takon e drejta në kompensimin e dëmit material për ndihmën dhe kujdesin e huaj dhe ushqimin e përforcuar, përkundër faktit se paditësja për këto kategori të dëmit nuk ka prezantuar prova konkrete materiale. pasi sipas praktikës gjyqësore shpërblimi për këtë kategori të dëmit si rregull gjykohet në shumën që nuk tejkalon 10€ në ditë, në raport me kohëzgjatjen e ndihmës së huaj dhe nevojës për ushqim të përforcuar, ashtu siç është gjykuar drejtë edhe nga gjykata e shkallës së parë.

Lartësia e kamatës është në pajtim me nenin 382 të LMD-së, duke filluar nga data e marrjes së aktgjykimit të shkallës së parë 15.11.2019, kur edhe konsiderohet që i padituri ka rënë në vonesë për përmbushjen e detyrimit.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me veprimet e ndërmarra në këtë procedurë dhe të cilat kanë qenë të nevojshme për ndjekjen e çështjes në gjykatë, poashtu shpenzimet janë në përputhje me tarifën për përcaktimin e lartësisë së shpenzimeve dhe në pajtim me dispozitat e LPK-së.

Pika II e dispozitivit të aktgjykimit të atakuar, në pjesën refuzuese të kërkesëpadisë nuk është shqyrtuar sepse ankesa nuk ka qenë e drejtuar përkitazi me pjesën e refuzuar të kërkesëpadisë.

Nga arsyet e paraqitura me lartë, e në pajtim me nenin 194, 195 paragrafi 1 pika d) dhe nenin 200 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË  
Ac.nr.545/20, me datë 24.05.2024

Kryetare e kolegjit  
Hunaida Pasuli